

VENDIM
Nr.668, datë 7.10.1996

PËR MARRJEN NË DORËZIM TË ARIT SHQIPTAR TË GRABITUR NGA GJERMANËT
GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në zbatim të ligjit nr.7913, datë 6.4.1995 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe SHBA-së, për zgjidhjen e disa pretendimeve” dhe ligjit nr.8141, datë 5.9.1996 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët”, si dhe marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze lidhur me zgjidhjen e çështjes së arit monetar dhe të detyrimeve të tjera publike dhe private, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të ngrihet grupi i punës për marrjen në dorëzim të arit shqiptar nga komisioni trepalësh, i përbërë prej:

- Kristaq Luniku Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
- Sherafedin Shehu zv. Ministër i Financave;
- Albert Bejo Drejtor Juridik në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

2. Ngarkohet Banka e Shqipërisë të kalojë për llogari të SHBA-së dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar shumat në dollarë amerikanë të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.7913, datë 6.4.1995 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe SHBA-së, për zgjidhjen e disa pretendimeve” dhe ligjin nr.8141, datë 5.9.1996 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi